



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 2402 Prot.

Tiranë, më 15 /07 /2026

V E N D I M

Nr. 15, datë 10.07.2026

P Ë R

**MIRATIMIN E PROJEKTEVE KËRKIMORE-SHKENCORE, PROPOZUAR PËR
PROGRAMIN E STUDIMIT TË CIKLIT TË TRETË “DOKTORATË” NË INXHINIERI
NDËRTIMI, NËNFUSHA INXHINIERI MJEDISI, TË RIORGANIZUAR, NË
FAKULTETIN E INXHINIERISË SË NDËRTIMIT, NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK
TË TIRANËS, PËR VITIN AKADEMIK 2026-2027**

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018, "Elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", i ndryshuar, Udhëzimit të MAS Nr. 1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njërive kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë" i ndryshuar, VKM 112, datë 23.02.2018, e ndryshuar, Urdhërit të MAS Nr. 178, datë 04.04.2022, Rregulloren e Studimeve të Doktoratës të UPT-së dhe kërkesën e Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit, Senati Akademik në mbledhjen e datës 10.07.2026,

VENDOSI:

Të miratojë projektet kërkimore shkencore me titull:

1. Vlerësimi teoriko eksperimental i procesit të termoizolimit të ndërtesave ekzistuese me muraturë tulle të papërfortuar, përmes metodologjisë së integruar energjetiko-mjedisore;
2. Analizë eksperimentale e uniformitetit dhe qëndrueshmërisë së parametrave operacionalë në simulime mjedisore të kontrolluara për vjetërimin klimatik të akseleruar të betoneve;
3. Analiza e ciklit të jetës dhe impakti mjedisor i materialeve FRP si armim i brendshëm alternativ në strukturat e reja dhe si përfortim i jashtëm në objektet ekzistuese prej betoni të armuar.

Propozuar për programin e studimit të ciklit të tretë "Doktoratë" në Inxhinieri Ndërtimi, nënfusha Inxhinieri Mjedisi, të riorganizuar, në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, në Universitetin Politeknik të Tiranës, për vitin akademik 2026-2027.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof. Dr. Akli Fundo

